



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN / MUNICIPALITY OF LIPJAN



## Drejtoria i Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

<b>Datë/Datum/ Date:</b>	05.06.2025
<b>Për/Za/For:</b>	<b>z. Imri Ahmeti</b> – Kryetar i Komunës së Lipjanit
<b>CC:</b>	<b>z. Diamant Bytyqi</b> – Nënkyetar i Komunës <b>z. Lulzim Qerimi</b> – Nënkyetar i Komunës <b>z. Avni Jashari</b> - Shef i Kabinetit të Kryetarit
<b>Nga/Od/From</b>	<b>z. Rexhep Rexhepi</b> - Drejtori i Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari
<b>Lënda/Subjecat/Subject:</b>	Raporti për muajin Maj

I nderuar Kryetar Z. Imri Ahmeti,

Të bashkangjitur gjeni Raportin mujor të aktiviteteve të Drejtoratit të Bujqësisë për periudhën nga 01.05.2025 deri me 31.05.2025

## PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

### SEKTORI I BUJQËSIË

Gjatë muajit maj, Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë ka realizuar një sërë aktivitetesh të rëndësishme për zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe mirëqenien e fermerëve në Komunën e Lipjanit. Më poshtë paraqiten aktivitetet kryesore:

Gjatë këtij muaji kemi pasur ceremonin e nënshkrimit të kontratave për subvencionimin e qumështit ku është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, ku morën pjesë të gjithë përfituesit dhe Kryetari i Komunës, z. Imri Ahmeti. Kjo shënon një hap të rëndësishëm në mbështetjen e sektorit të blegtorisë, duke rritur motivimin e fermerëve për të shtuar prodhimin dhe për të përmirësuar cilësinë e produkteve të tyre. Statistikat për dorëzimin e qumështit gjatë këtij viti tregojnë një rritje prej 202,000 litra krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ky progres i dukshëm është dëshmi e drejtpërdrejtë e efektivitetit të skemës së subvencionimit për litër qumësht.

Drejtori i Drejtorisë, së bashku me Kryetarin e Komunës, ka zhvilluar vizita në terren për të inspektuar montimin dhe cilësinë e serave të shpërndara te fermerët. Gjatë këtyre vizitave është evidentuar kënaqësia e madhe e përfituesve, të cilët theksuan se këto sera kanë përmirësuar dukshëm prodhimin e perimeve. Përveç përmirësimit të nevojave familjare, prodhimi i perimeve u ka mundësuar shumë fermerëve të krijojnë të ardhura shtesë përmes shitjes në treg, duke kontribuar kështu në zhvillimin ekonomik lokal.

Procesi i regjistrimit të fermerëve në programin e pagesave direkte ka përfunduar me sukses, duke përfshirë rreth 1,750 aplikues. Ky proces është përmirësuar dukshëm krahasuar me vitet e kaluara, falë angazhimit dhe shtimit të stafit në drejtorinë e bujqësisë, që ka mundësuar trajtimin më efikas të aplikimeve dhe shmangien e pritjeve të gjata. Të gjitha lëndët janë përcjellë me kohë në Ministrinë e Bujqësisë për shqyrtim të mëtejshëm.

Janë ndërmarrë hapa konkretë për trajtimin e qenve endacakë në çdo lagje dhe fshat të Komunës. Këto veprime janë realizuar në bashkëpunim të ngushtë me qytetarët dhe institucionet përkatëse, me qëllim rritjen e sigurisë për banorët dhe krijimin e kushteve më të mira për trajtimin e qenëve pa pronar.

Ka vazhduar zhavorimi i rrugëve të kategorisë së katërt, një proces që ka ndikuar ndjeshëm në përmirësimin e infrastrukturës për tokat bujqësore. Ky aktivitet e ka lehtësuar qasjen e fermerëve në tokat e tyre bujqësore, veçanërisht në zonat më të thella, duke kontribuar në rritjen e efikasitetit të punës dhe transportit të produkteve bujqësore. Fermerët e kanë mirëpritur shumë mire zhavorimin e rrugëve fushore, ndërsa punimet do të vazhdojnë edhe gjatë muajve në vijim.


Procedurat për shpërndarja e motokultivatorëve planifikohet të realizohet gjatë muajit qershor. Këto pajisje do të ofrojnë mbështetje të rëndësishme për fermerët, duke i ndihmuar ata të punojnë tokat me më pak lodhje fizike dhe me më shumë efikasitet, veçanërisht në sipërfaqe më të vogla bujqësore. Pritet që kjo masë të përmirësojë rendimentin dhe të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm rural.

Procedurat për shpërndarjen e serave me sipërfaqe prej 50m<sup>2</sup>, të cilat parashikohet të montohen gjatë muajve qershor dhe korrik. Deri më tani, gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore, janë mbështetur rreth 300 përfitues, ndërsa mbi 300 aplikues të tjerë janë në proces shqyrtimi. Ky projekt ka për qëllim rritjen e kapaciteteve prodhuese të fermerëve të vegjël dhe përmirësimin e sigurisë ushqimore.

Gjatë muajit Maj janë zhvilluar takime të rëndësishme me organizata ndërkombëtare, përfshirë edhe organizatën e Katarit, me të cilën po zbatohet me sukses projekti për hapjen e puseve të ujit të pijëshëm për familjet me kushte të rënda ekonomike. Deri tani janë hapur 104 puse, duke ndikuar ndjeshëm në përmirësimin dhe ofrimin me ujë të pijshëm për shumë familje. Po ashtu, janë në diskutim projekte të reja për shpërndarjen e serave, duke thelluar më tej bashkëpunimin me organizata ndërkombëtar në fushën e bujqësisë

Gjatë këtij muaji komisioni komunal nga Drejtoria e Bujqësisë ka dalë në terren në mënyrë të rregullt, sipas kërkesave të fermerëve, për të ofruar këshilla profesionale dhe për të vlerësuar dëmet eventuale në kultura bujqësore. Kjo mbështetje teknike synon që çdo fermer të marrë informacionin dhe ndihmën e nevojshme në kohë, duke ndihmuar në marrjen e masave të duhura për të minimizuar humbjet dhe për të siguruar një prodhim sa më të qëndrueshëm.

Me anë të kesaj tabele paraqesim të dhënat për sipërfaqen e tokë punuese në Komunën e Lipjanit -2025  
Këto të dhëna janë marrur nga Prgorami i Pagesave direkte per vitin 2025



Me anë të kesaj tabele paraqesim të dhënat për sektorin e blegtoris në Komunën e Lipjanit -2025  
 Këto të dhëna janë marrur nga Prgorami i Pagesave direkte per vitin 2025

Nr.	Kafsha	Totali
1	Lope Qumeshtore	1936
2	Buallica Qumeshtore	0
3	Meshqerra per Riprodhim	199
4	Dele per mbareshtim	4218
5	Dhi per Mbareshtim	887
6	Koshere Bletesh	5411
7	Dosa per Riprodhim	20
8	Pula vojse	2600
9	Therrijet e raportuara te gjedhit	0
10	Akuakulture	0
11	Viqa per Majmeri	0
12	Zogje per Majmeri (brojlere)	0

